



Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0841
Data e Vendimit: 10.11.2023

Në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE “GeoTech” SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente GPS” me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KK Gjakovë, Kryetari i Panelit Shqyrtues, Vedat Poterqoi, me datën: 10/11/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar, ankesa e OE “GeoTech” SH.P.K, me nr. të protokollit 2023/0841, e datës 03/11/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente GPS”, me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KK Gjakovë.

Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është çështje e gjykuar sipas vendimit të OSHP-së me Nr. 200/23,

I lejohe, autoritetit kontraktues – KK Gjakovë që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me instrumente GPS”, me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që brenda 60 dite të bejë kërkesën për kthim të mjeteve të parapara në nenin 31 pika 6 e Rregullores së Punës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me datë 03.08.2022, "KK Gjakovë", ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me instrumente GPS", me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1.

AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, për operatorin ekonomik te rekomanduar "DWH-KOSOVA" SH.P.K me datën 11.10.2023.

Me datën 17.10.2023 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 11.10.2023, operatori ekonomik "GeoTech" SH.P.K. AK me datën 20.10.2023, refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 27.10.2023 ka pranuar ankesën me Nr. protokollit 841/23 nga operatori ekonomik "GeoTech" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrumente GPS", me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga KK Gjakovë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me instrumente GPS", me numër të prokurimit 632-22-7865-1-2-1, iniciuar nga KK Gjakovë, konstatohet se njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 03.08.2022. Operatori ekonomik me të dhënat e cekura si më lartë, me datën 27.10.2023, si pale e pakënaqur me vendimin për dhënie të AK-së së datës 11.10.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP (Protokoll 841/23).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit dhe realizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, konstaton se për këtë procedurë të prokurimit OE "GeoTech" SH.P.K, ka parashtruar edhe më parë ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0200, për të cilin OSHP me datën 13.06.2023, ka marrë vendim me të cilën ankesën e ka refuzuar si te pa bazuar, dhe OE është klasifikuar si i pa përgjegjshëm.

Pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë procedurë të prokurimit, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues e pranuar në OSHP me datën 27.10.2023 është e palejuar sepse e njëjta është çështje e gjykuar "Res Judicata" më parë dhe për të njëjtin tashmë është marrë vendim.

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, OSHP e hedhë si te pa lejuar ankesën e parashtruar me datën 27.10.2023 me nr. protokollit 841/23 nga operatori ekonomik "GeoTech" SH.P.K, sepse ankesa për këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: "*Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata", dhe konfrom nenit 4, 1. 26 të ligjit, OE ankues "GeoTech" SH.P.K, me emrin tregtar konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak se me vendimin 200/23, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së*

interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.

OSHP, sqaron se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit të lart cekur në OSHP janë paraqitur dy nr.188/23 për të cilën paneli shqyrtues ka marr vendim me të cilën e ka aprovuar ankesën si të bazuar dhe kthen lenden në Rivlerësim, si dhe ankesën me nr.200/23 "GeoTech" SH.P.K të cilën paneli shqyrtues ka vendosur që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Autoriteti kontraktues – KK Gjakovë, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veprojë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP.

Duke qenë se OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës ka paguar tarifë, e njëjta konform nenit 31, par 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet që kërkesën për kthim të mjeteve të parashtrorë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.

Kryetari i PSH-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - KOMUNA E GJAKOVËS
- OE - " GeoTECH " SH.P.K.
- Arkivës së OSHP-së: